



Evro-za vse nas

Euro-ja po vjen



Parathënie	2
I. Përse po fusim euron	4
Çfarë na sjell aplikimi i euros	4
II. Mbi euron	5
Çfarë është euro-ja	5
Ku mund të paguajmë me euro	5
III. Përdorimi i euros në Slloveni	6
Si mund të përgatitemi për përdorimin e euros	7
Datat kryesore për futjen e euros	7
Shënimi i dyfishtë i çmimeve	8
<i>Rregullat e përlogaritjes</i>	10
<i>Rregullat e përfrimit</i>	10
Kërkoni që t'ju kthehen monedhat me vlerë të vogël!	11
IV. Informata plotësuese	15

Slovenia me rastin anëtarësimit të sajë në Bashkimin Evropian, vendosi për të ardhmen e përbashkët evropiane, dhe me këtë rast u përcaktua për valutën e sajë-euro. Për futjen e euros, duhet që shteti anëtar i Bashkimit Evropian të plotësojë disa kushte, të ashtuquajtura kritere konvergjente apo kriteret e mastrikt-it. Veçoria esenciale e kushteve të sipërpërmendura është qëndrueshmëria: shteti i cili është kandidat për pranimin e euros duhet të tregojë qëndrueshmëri në financat publike, qëndrueshmërinë e çmimeve, kamatave dhe qëndrueshmërinë e kursit valutor, të cilat së bashku dëshmojnë për ekonominë e qëndrueshme. Hapin e parë për pranimin e euros, Sllovenia e ka ndërmarrë me rastin e kyçjes në mekanizmin e kursit valutor (ERM II) më 28. qershor 2004. Nëse pas dy viteve të bashkëpunimit në mekanizmin e sipërpërmendur, do t'i plotësojmë të gjitha konditat e përcaktuara, atëherë, me 1. janar 2007 euro-ja do të behet valutë e jonë.

Meqë mendimet, për dobinë e valutës së përbashkët në rrafshin evropian janë të ndara, lehtë mundemi që me një ekonomi të hapur, siç është ajo sllovene, me arsytim t'i vlerësojmë rreziqet eventuale. Dobi nga futja e valutës së përbashkët, do të kenë, jo vetëm shteti, ekonomia dhe punëdhënësit, por këtë do t'a ndiejnë edhe çdo kush prej nesh. Euro-ja është valutë e qëndrueshme. Me këtë valutë, qysh tani mund të blejmë në 12 vende të Bashkimit Evropian, kurse me hyrjen e shteteve të reja në hapësirën-zonën e euros, këto mundësi vetëm sa zgjerohen. Kur do të shkojmë atje në vizita, në udhëtime afariste, në pushime, piknikë ose për të blerë diçka, nuk do të ketë nevojë që ta bëjmë këmbimin e monedhave. Ekonomisë sllovene, euro-ja do e ndihmojë që sa më mirë t'i shfrytëzojë përparësitë e tregut të përbashkët evropian, kurse ne konsumatorët, do t'a kemi më të lehtë të bëjmë krahasimin e çmimeve të njëjtave prodhimeve, në mes të shteteve të ndryshme. Evropa, në lidhje me këtë, qysh moti i ka tejkaluar kornizat e BE, dhe kështu është prezentë edhe në shtetet e treta.

Një valutë, do të thotë, ndërlidhje më e mirë e Bashkimit Evropian. Euro-ja gjatë viteve është treguar, jo vetëm si valutë e qëndrueshme ndërkombëtare, por ajo shfaqet edhe si simbol i përbashkët i identitetit evropian, i vlerave të përbashkëta të më shumë se treqind milionësh njerëzve. Ajo ka dëshmuar, se është momenti shumë i volitshëm për realizimin e tregut të hapur, konkurrent dhe të qëndrueshëm.

Përgatitjet për (futjen) e euros në Slloveni, janë duke u zhvilluar intensivisht. Qeveria e Republikës së Sllovenisë, së bashku me Bankën e Sllovenisë, janë duke bërë përgatitjet dhe udhëheqin këtë proces, në të cilin kanë kyçur edhe institucionet e rëndësishme, si ato në rrafshin shtetëror, ashtu edhe në atë lokal. Jemi të vetëdijshëm, se për arritjen e rezultatit të këtij projekti, është shumë me rëndësi, që në këto procese dhe përgatitje të angazhohjmë edhe qytetarët dhe qytetarët e Sllovenisë.

Qeveria e RS dhe Banka e Sllovenisë, për këtë qëllim kanë përgatitur një program voluminoz të lajmërimit publik. Broshura e cila gjendet para jush, është një hyrje në këto aktivitete. Në këtë broshurë, dëshirojmë, që në vitin e përgatitjeve intensive për pranimin e euros, që së pari tu prezantojmë veprimtarinë dhe funksionimin e hapësirës evropiane me valutë të përbashkët euro, rolin e Sllovenisë në këtë proces, të prezantojmë kartëmonedhat dhe monedhat metalike. Nuk kemi aspak dyshim, që shumica prej jush është takuar me euron, por, besojmë që kjo broshurë do të jetë e mirëseardhur. Fundi i fundit, në fillim të shënimit të dyfishtë të çmimeve, dëshirojmë që në këtë mënyrë t'u ndihmojmë, që sa më lehtë dhe më shpejtë të adoptoheni në euro-si valutë e jonë e ardhshme, pjesë e përbashkët e ardhmërisë evropiane.

dr. Andrej Bajuk,
ministri i financave



I. Përse po fusim euron

Me rastin e hyrjes në Bashkimin Evropian (1. maji 2004), Sllovenia u zotua se do të fusë monedhën e përbashkët evropiane - euron. Ndonëse ky detyrim ishte pjesë e kontratës fillestare, duhet që së pari t'i plotësojmë gjashtë kriteret konvergjente. Ky objektivi ka qenë pikësynimi i ekonomisë dhe edhe politikës financiare.

Kur monedhën e përbashkët Evropiane si monedhë biznesi e futën 11 shtetet e BE-së, (më vonë Euron e futi edhe Greqia), shtetet anëtare, kishin mundësinë që të vendosnin nëse do t'a fushnin euron, apo jo. Britania e Madhe dhe Danimarka kanë vendosur të ruajnë monedhën e tyre: i dhanë të drejtë të veçantë vetes, e drejtë kjo që ju ju dha mundësinë atyre që për to të mos ishte e domosdoshme dhe e nevojshme futja e euros, ndonëse i plotësonin kriteret konvergjente. Suedia, tani për tani nuk i plotëson kriteret konvergjente për futjen e euros, për këtë arsye mbetet jashtë mekanizmave të kurseve valutore (ERM II). Për shtetet e reja anëtare të BE-së, duke përfshirë edhe Slloveninë, kjo nuk mundësi ekziston. Të gjitha këto shtete anëtare, duhet të zhvillojnë një politikë ekonomike dhe financiare në të tillë kahje që sa më shpejtë t'i plotësojnë kriteret konvergjente dhe në këtë mënyrë të përgatiten për aplikimin e euros.

4

Çfarë na sjell aplikimi i euros!


Futja e euros në Slloveni, midis të tjerash sjell këto përparësi:

- formimin e ambientit të qëndrueshëm për tërë ekonominë, për shkak të anulimit të ndryshimit të kursit valutore midis shteteve, të cilat kanë futur euron, dhe në këtë mënyrë kanë anuluar rreziqet e pa parashikuara dhe shpenzimet e këmbimit;
- lirshme më të tregti në tregjet jo Evropiane;
- krahasimin më të mirë të çmimeve vendore të prodhimeve dhe shërbimeve me çmimet në shtetet e ashtuquajtura “zona e euros”;
- konkurrencë më e madhe, si pasojë e krahasimit të çmimeve në zonën e euros;
- anulimi i shpenzimeve për shkak të këmbimit të valutës;
- zgjedhje më të madhe të formave të kursimit dhe mundësi më të lehtë të aplikimit të kredive. Nuk është më e nevojshme, që para se të udhëtohet, ose gjatë udhëtimit për në Evropë dhe botë të kërko-hen pa nevojë zyrat e këmbimit.

II. Mbi euron

Çfarë është euro-ja

Euro-ja është valutë e Bashkimit Evropian. Deri me tani e kanë futur 12 shtete të Bashkimit Evropian, të cilat së bashku formojnë rajonin e euros. Këto shtete i kanë plotësuar konditat, të cilat kanë qenë kusht para futjes së euros.



Pjesë e zonës së euros janë Austria, Belgjika, Finlanda, Franca, Gjermania, Greqia, Holanda, Irlanda, Italia, Luksemburgu, Portugalia dhe Spanja.

Ku mund të pagujmë me euro


- në 12 shtete anëtare të BE: Austri, Belgjikë, Finlandë, Francë, Gjermani, Greqi, Holandë, Irlandë, Itali, Luksemburg, Portugali dhe Spanjë;
- në Monako, Vatikan dhe San Marino, të cilat kanë arritur një marrëveshje me BE-në për përdorimin e euros;
- në vendet Franceze përtej detit, të cilat formalisht nuk janë pjesë e BE, por që para futjes së euros, kishin përdorur frangun francez;
- në shtetet, përkatësisht në ato pjesë shtetesh, ku euro përdoret si pasardhës i monedhave të vjetra; këto raste janë Andorra, e cila kurrë nuk ka pasur monedhën e vet, deri më tani ajo ka përdorur pesetën spanjolle dhe frangun francez, si dhe Kosova dhe Mali i Zi, ku euron e përdorën si trashëgues të markës gjermane.

III. Përdorimi i euros në Slloveni

Në Slloveni, do t'a fusim euron, mundësisht me 1 janar 2007. Pas futjes së kartëmonedhave euro dhe euro monedhave metalike, do të kalojë një kohë relativisht e shkurtër, ku do të ketë qarkullim të dyfishtë, të tollarit dhe euros. Shkëmbimi pa pagesë i monedhave tollar në bankat është i mundshëm deri në fund të shkurtit 2007, pas kësaj periudhe, shkëmbimi i kartëmonedhave tollar është i mundur pranë Bankës së Sllovenisë, pa kufizim kohor, kurse shkëmbimi i monedhave metalike tollar është i mundur deri në fund të viti 2016.

Korniza kohore e veprimtarisë me rastin e futjes se euros*

**Te gjitha datat jane te kushtëzuara.*



Periudha e qarkullimit të dyfishtë, ku mund të bëjmë pagesa me tollar dhe euro, periudhë kjo, që do të jetë shumë e shkurtër, për këtë arsye është e preferueshme, që para 31. dhjetorit 2006, të depozitohet sa më tepër para bankënota në llogaritë bankare, sepse, automatikisht në atë mënyrë do të përlllogariten në euro.

Si mund të përgatitemi për aplikimin e euros

Futja e kartëmonedhës së re është një projekt, që i përket të gjithëve; shtetit, ekonomisë së tij dhe banorëve. Përgatitja e mirë, për pranimin e euros në nivel shtetëror dhe në ekonominë shtetërore, në esencë do ta lehtësojë futjen e kartëmonedhës edhe tek individit. Informimi i mirë i konsumatorëve është element shumë i rëndësishëm, për zhvillimin pa pengesë të këmbimit të tollarëve në euro.

Me rëndësi është, që të njihemi me datat kyçe të planit për aplikimin e euros.

1. janar 2007 - data e përcaktuar për përdorimin e euros, me të cilën janë të lidhura të gjitha datat e tjera; a do të futet me të vërtet euro-ja me 1. janar 2007, varet prej asaj, se si Sllovenia po i plotëson kriteret e kërkuara;

1. janar 2007 - 14. janar 2007 - periudha e qarkullimit të dyfishtë të euros dhe tollarit: në këtë kohë, euro është kartëmonedhë vendore, por me para të gatshme, edhe më tutje do të jetë e mundur pagesa edhe në tollar;

1. janar 2007 - 1. mars 2007 - është e mundur këmbimi i monedhave pranë bankës, pa përçindje, pas skadimit të këtij afati, këmbimi mund të bëhet në Bankën e Sllovenisë, pa kufizim kohe për kartëmonedhate; ndërsa për monedhat metalike tollar, deri në fund të vitit 2016; të gjitha monedhat e regjistruara, por edhe monedhat në llogarinë rrjedhëse, do të llogariten automatikisht në euro prej 1. janarit 2007.

Me rëndësi është, se me anë të shënimit të dyfishtë përcjellim çmimet; nëse ato janë të përlllogaritura dhe nëse shumat janë të përafuara sipas rregullave të përcaktuara.

Shënimi i dyfishtë i çmimeve ju ndihmon juve si konsumatorë, që të përshtateni në shprehjen e vlerave me monedhën e re, kurse shënimi i çmimeve në tollar dhe euro; na ndihmon neve që të zbulojmë llogaritë e parregullta, në përgjithësi përafrimin. Forma

e detyruar e shënimit të dyfishtë në listën e çmimeve dhe të shërbimeve, para dhe pas futjes së euros, është përcaktuar në ligjin për shënimin e dyfishtë të çmimeve.

Shënimi i dyfishtë i çmimeve do të ndahet në dy periudha:

periudha e detyruar për shënimin informativ të dyfishtë të

çmimeve, do të fillon më 1. mars 2006 dhe do të përfundojë në ditën e caktimit të *kursit të këmbimit*¹. Në këtë periudhë, çmimet duhet të shënohen njëkohësisht në tollar dhe euro dhe të përlogaritura sipas *kursit qendror*²;

periudha e shënimi të dyfishtë të çmimeve, do të fillojë në datën e caktimit të kursit të këmbimit dhe do të përfundojë, gjashtë muaj pas futjes së euros.

Gjatë gjithë kohëzgjatjes së shënimit të dyfishtë të çmimeve; çmimet e produkteve dhe shërbimeve duhet të jenë të shënuara në të dy valutat dhe të shtypura në listë e çmimeve, në mënyrë që çdo konsumator, thjesht dhe padyshim ta lexon dhe krahasojë çmimin. Janë të parashikuara edhe disa përjashtime:

në pika karburantesh duhet që në pompën për mbushjen me karburant, ose në afërsi të sajë, të shënohet çmimi për një litër, në të dy valutat si dhe kursi i këmbimit. Çmimi i shënuar në euro për një litër karburant, duhet të shprehet në vlerë me tre numra pas presjes dhjetore;

ndërmarrjet të cilat ofrojnë mallra dhe shërbime përmes katalogëve duhet që çmimet t'i paraqesin vetëm në valutën në fuqi, në datën e daljes së katalogut, kurse informatën për këmbimin e valutës duhet t'ia bashkëngjisin së bashku me listën e çmimeve të artikujve në listën e katalogut në të dy valutat, të renditura në rritje;

¹ Kursi i këmbimit është marrëdhënia permanente e parevokueshme në mes tollarit dhe euros, të cilin do ta caktojë Këshilli i BE-së.

² Këmbimi valutor qendror, paraqet këmbimin, i cili është caktuar me rastin e hyrjes së Sllovenisë në Mekanizmat e kurseve valutore (EMR II), e ashtuquajtura euro pritësja (1 € = 239,640 SIT).

- në dyqanet e prodhimeve të mishit, dyqanet me peshk**, në ëmbël-tore dhe dyqane të bukës, duhet të jetë në një vend publik lista e çmimeve për të gjithë artikujt në të dy valutat;
- shitja e artikujve dhe shërbimeve përmes njësive shitëse**, kursin e këmbimeve dhe listën e çmimeve duhet t'a kenë në një vend publik gjithë për të artikujt dhe shërbimet, në të dy valutat;
- për shitjen e librave dhe botimeve të tjera, duhet të jetë në një vend publik**, kursi i këmbimeve dhe tabela llogaritëse, në të cilën janë shënuar çmimet tipike, së paku të tridhjetë librave, përgjithësisht të artikujve të tjerë botues, sipas zgjedhjes së shitësit, në renditje rritëse, në të dy valutat;
- ndërmarrjet, të cilat bëjnë pranimin e pagesave për lojërat e fatit, ose kryejnë shërbime të tjera në lidhje me çfarëdo lloj loje të fatit**, duhet ta kenë në vendin e shitjes dhe në auto distributorët shitëse të lojërave të fatit, në një vend publik kursin e këmbimeve dhe listën e çmimeve në të dy valutat;
- ndërmarrjet e vogla, të cilat kryejnë veprimtari tregtare dhe kanë të punësuar më shumë se dhjetë persona**, munden që në dyqanin, në të cilin, njëkohësisht janë të punësuar më shumë se pesë persona, të përdorin mënyrat alternative, kështu t'i mundësojnë konsumatorit përlllogaritjen dhe krahasimin e çmimeve, në tollar dhe euro, p.sh. me përdorimin e listave të çmimeve ose tabelave përlllogaritëse. E njëjta gjë vlen edhe për ndërmarrjet të cilat kryejnë veprimtari artizanale;
- ndërmarrjet të cilat ofrojnë artikuj dhe shërbime për lidhjen e punëve juridike**, çmimet, vlerat e ngarkimeve, ndjekjeve dhe detyrimeve i shfaqin në euro;
- bujqit**, të cilët ia shesin artikujt e tyre drejtpërdrejt konsumatorit të fundit.

Shënimi i dyfishtë, nuk do të jetë i detyrueshëm në shënimin e çmimeve për njësi të produktit (p.sh. kilogram, metër, copë), shumat në shkresat e peshoreve dhe treguesve digjital të çmimeve si dhe vlerave të pullave postare.

Çfarë janë rregullat e përafrimit dhe përlllogaritjes

Rregullat e përlllogaritjes në periudhën e informimit të detyrueshëm të shënimeve të dyfishta të çmimeve

Prej 1. marsit 2006 e deri në caktimin e kursit të këmbimit, shumat do të përlllogariten në mënyrë informative sipas kursit qendror. Shuma në euro llogaritet e tillë që, shumata në tollar pjesëtohet me **kursin qendror** (1 € = 239,640 SIT).

Gjatë përafrimit të shumave vlejnjë rregullat e përafrimit.

Rregullat e përlllogaritjes në periudhën e shënimit të dyfishtë të çmimeve

Sipas caktimit të kursit të përvokueshëm të këmbimit do të caktohet kursi për 1 euro. Në rastin e përlllogaritjes, kursi i këmbimit nuk përafrohet apo thjeshtohet dhe se ai përdoret për përlllogaritjen midis njësisë së euros dhe njësisë së tollarit, në të dy drejtimet. Gjithashtu edhe në këtë rast vlejnjë rregullat e përafrimit.

Rregullat e përafrimit

Rregullat e përafrimit janë të njëjta gjatë gjithë periudhës, pavarësisht se sipas cilit kurs zhvillohet përlllogaritja e çmimeve.

Gjatë përafrimit, shumata e monedhave në euro përafrohet në rritje, në më të afërmin cent. Nëse rezultati i përlllogaritjes është shumata e cila paraqet saktësisht mesin, kjo shumë rrumbullakohet në rritje.

1. nëse numri i vendit të tretë i numrit dhjetor është **më i vogël se pesë**, atëherë shumata në euro përafrohet në zbritje:
(p.sh.. 24,784 EUR do jetë 24,78 EUR);
2. nëse numri i vendit të tretë i numrit dhjetor është **pesë ose më tepër**, atëherë shumata në euro përafrohet në rritje
(p.sh.. 24,785 EUR do jetë 24,79 EUR).

Shembulli për përafrimin gjatë përlllogaritjes në bazë të kursit qendror

Shembulli nr. 1:

$500 \text{ SIT} = 500 : 239,640 = 2,0864... \rightarrow 2,09 \text{ EUR}$
(sepse numri i vendit të tretë i numrit dhjetor është pesë ose më tepër, atëherë shuma në euro përafrohet në rritje).

Shembulli nr. 2:

$1.000 \text{ SIT} = 1.000 \div 239,640 = 4,1729... \rightarrow 4,17 \text{ EUR}$
(sepse numri i vendit të tretë të numrit dhjetor është më i vogël se pesë, atëherë shuma në euro përafrohet në zbritje).

Kërkoni që t'ju kthehen monedhat me vlerë të vogël!

Në rastin e bërjes së pagesës në tollar, kthimit të monedhave të imta nuk i vëmë rëndësi, për këtë arsye sillen nëpër arka, në xhepa.

Me futjen e euros, pagesa me monedha metalike të vlerave të vogla do të jetë shumë e rëndësishme, sepse çmimet e artikujve kryesor jetësor, p.sh. bukës dhe prodhimeve të miellit, do të sillen aty afër

1 euro. Për këtë arsye në xhepat tonë do të nevojitet çdo cent, të cilin pa kujdes do ta lëmë në arkë. Duhet të mësohemi dhe të adaptohemi, që monedhat metalike t'i përdorim shpesh, në vend që t'i ruajmë në shtëpi. Monedhat metalike janë monedha pagese, të cilat janë të vlefshme sikurse kartëmonedhat.

Euro kartëmonedhat

Kartëmonedhat janë lëshuar në shtatë vlera të ndryshme: 5 €, 10 €, 20 €, 50 €, 100 €, 200 € dhe 500 €. Këto janë mjete pagese ligjore në tërë hapësirën e euros..

Çdo kartëmonedhë paraqet një prej stileve të arkitekturës evropiane:

- klasiken
- romaken
- gotiken
- renesancën
- barokun dhe rokoko
- arkitektura e hekurit dhe e qelqit
- arkitektura bashkëkohore e shekullit të 20.

Në faqen e parë janë të vendosura dritaret dhe dyert, të cilat simbolizojnë shpirtin e hapur për bashkëpunim evropian. 12 yje të Bashkimit Evropian paraqesin dinamikën dhe harmoninë e Evropës bashkëkohore. Urat në faqen e prapme simbolizojnë komunikimin në mes të popujve të Evropës dhe botës tjetër.



Evro-za vse nas



Euro monedhat

Monedhat

Monedhat metalike janë lëshuar në tetë vlera të ndryshme: 1, 2, 5, 10, 20 dhe 50 cent, 1€ dhe 2€. Të gjitha këta kanë të njëjtë pjesën e përparme, kurse pjesa e prapme dallohet prej shteti në shtet. Faqja nacionale tregon se në cilin shtet janë lëshuar monedhat metalike.



Faqja nacionale e monedhave metalike

Dr. France Prešeren



Primož Trubar



Triglav



lipicanët



Projekti i Plečnik për parlamentin sloven



Mbjallësi i Ivan Grohar



guri i princit



lejleku

IV. Informata plotësuese

Sa më shumë që afrohet koha e futjes së euros, aq më shumë pyetje janë duke u shtruar. Kemi grumbulluar disa burime informatash, në të cilat mund të drejtoheni gjatë hulumtimeve të pyetjeve tuaja.

Në **eurofon 080 2002** numri telefonik pa pagesë, mund të parashtroni pyetje për futjen e euros në Slloveni, për rrjedhat e përgatitjeve, kryerjen e këmbimit dhe çfarëdo lloj pyetje tjetër. Numri i eurofonit 080 2002 është gjithashtu numër, përmes të cilit mund të lajmëroni parregullsitë eventuale, të cilat do t'i ndeshni gjatë përlllogaritjes së çmimeve prej tollarit në euro, përafrimit të shumave ose mos respektimit të rregullave të shënimit të dyfishtë.

Për parashtrimin e pyetjeve apo kërkesën e informacionit publik për futjen e euros mund të përdorni edhe fletë-shkresat mbi euron, të cilat janë në dispozicion në postat e Sllovenisë.

Faqja e internetit **www.evro.si** është një burim i begatshëm informativ për të gjithë ata që janë të interesuar për informacione më të hollësishme mbi euron dhe përgatitjet për futjen e saj në Slloveni. Këtu do të gjeni shumë informata praktike për rrjedhat e këmbimit, përveç kësaj edhe për lidhjet e shumëfishta në faqet më të specializuara të internetit. Disa prej tyre po i vendosim këtu:

Banka e Sllovenisë

<http://www.bsi.si>

Ministria e Financave

<http://www.gov.si/mf/>

Dhoma e Tregtisë e Sllovenisë

<http://www.gzs.si>

Banka Qendrore e Evropës

<http://www.ecb.int>

Komisioni Evropian

<http://europa.eu.int/comm>

*Për një informacion të përgjithshëm mbi Bashkimin Evropian, institucionet e tij dhe programet, si dhe për veprimtarinë e Sllovenisë si anëtare e BE-së, mund edhe më tutje të telefononi në eurofonin **080 2002** ose të vizitoni faqen e internetit <http://evropa.gov.si>*



Evro-za vse nas

Botoi:

Qeveria e Republikës Sllovenisë

(në emër të sajë: Drejtiria e Qeverisë së RS për informim) dhe

Banka e Sllovenisë

Redatktor kryesor:

Alenka Čebular

Špela Majcen

Këshilli botues:

Alenka Čebular, Nada Bizjak,

Vladimir Djorović, Nataša Kokol Car,

Špela Majcen, Darja Rabzelj

Design:

Edi Berk / KROG

Përkthyesi:

Xhavit Shaqiri

Shtypur:

OPOCE

Tirazhi:

10.000

Mars 2006

*Produced with the support of the
European Commission.*

*©Responsibility for the content of the brochures
lies entirely with the Government of the
Republic of Slovenia and Bank of Slovenia.*



REPUBLIKA SLOVENIJA
VLADA REPUBLIKE SLOVENIJE

**BANKA
SLOVENIJE**



enoten denar  več priložnosti



Evro-za vse nas



ISBN 92-79-01215-0



9 789279 012150